




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI



URDHËR

Nr. _____, datë _____

PËR

NGRITJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E RRJETIT TË KOORDINATORËVE TË BIZNESIT

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të vendimit nr.638, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e rrjetit të koordinatorëve të biznesit, nën koordinimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.
 2. Misioni i rrjetit të koordinatorëve të biznesit është referimi dhe trajtimi i ankesave, i nismave, sugjerimeve, iniciativave, denoncimeve për sjellje abuzive apo korruptive të ardhura nga sipërmarrjet private, të cilat adresohen në platformën elektronike "Me ty, për Shqipërinë që duam", në bashkërendim me ministritë dhe institucionet e varësisë.
 3. Rrjeti i koordinatorëve të biznesit shtrihet në nivel qendror dhe në bazë të detyrave funksionale kategorizohet në:
 - a) Koordinator biznesi i Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (këtu e në vijim koordinator biznesi në Kryeministri);
 - b) Koordinator biznesi në ministri;
 - c) Koordinator biznesi në një institucion varësie të Kryeministrisë/ministrisë.
- 3.1 Rrjeti i koordinatorëve të biznesit të ushtrorë funksionin e koordinatorit në institucionet e mëposhtme:

- a) Kryeministria dhe institucioni në varësi të saj:
 - i. Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
- b) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucionet e mëposhtme në varësi të saj:
 - i. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;
 - ii. Autoriteti Rrugor Shqiptar;
 - iii. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
 - iv. Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial;
 - v. Posta Shqiptare;
 - vi. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.
- c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e mëposhtme në varësi të saj:
 - i. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
 - ii. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
 - iii. Qendra Kombëtare e Biznesit;
 - iv. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale.
- ç) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e mëposhtme në varësi të saj:
 - i. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
 - ii. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.
- d) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e mëposhtme në varësi të saj:
 - i. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
 - ii. Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
- dh) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e mëposhtme në varësi të saj:
 - i. Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
- e) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- ë) Ministria e Brendshme;
- f) Ministria e Drejtësisë;
- g) Ministria e Kulturës;
- gj) Ministria e Mbrojtjes;
- h) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;

- i) Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.
4. Në institucionet e administratës shtetërore, të përcaktuara në pikën 3.1, të këtij urdhri, krijohet pozicioni "koordinator biznesi", si pjesë e rrjetit. Koordinatori caktohet nga titullari i institucionit, ndër funksionarët që institucioni ka, i cili duhet të ketë integritet dhe reputacion të lartë profesional.
 5. Koordinator i rrjetit të biznesit në Kryeministri t'i përgjigjet titullarit të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.
 6. Koordinator i rrjetit të biznesit t'i përgjigjet ministrit dhe titullarit të institucionit të varësisë, sipas përcaktimeve në pikën 3.1, të këtij urdhri, dhe koordinatorit të biznesit në Kryeministri, për të gjithë veprimtarinë e ushtruar në rolin e koordinatorit të biznesit.
 7. Detyrat funksionale të koordinatorëve të biznesit janë sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
 8. Nëpunësit e tjerë të institucioneve të listuara në pikën 3.1, të këtij urdhri, pranë të cilave ushtrojnë funksionet koordinatorët e rrjetit të biznesit, të mos kenë akses në bazën e të dhënave të platformës elektronike "Me ty, për Shqipërinë që duam".
 9. Rregulla të hollësishme lidhur me procedurën e përzgjedhjes së koordinatorëve të rrjetit të biznesit, të trajtimit të rasteve, të detyrave dhe të afateve sipas pikës 6, të këtij urdhri, përcaktohen me urdhër të brendshëm nga titullari i ministrisë.
 10. Institucionet e përcaktuara sipas pikës 3.1, të këtij urdhri, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij, të fillojnë procedurën teknike dhe ligjore me qëllim përfshirjen në to të pozicionit "Koordinator i rrjetit të biznesit".
 11. Ngarkohen Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe institucionet e përmendura në pikën 3.1, të këtij urdhri, për ndjekjen dhe zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Shtojca 1

Detyrat funksionale të koordinatorit të biznesit

1. Koordinatorit i biznesit kryen detyrat funksionale, si më poshtë vijon:
 - a) Proceson nga sistemi i menaxhimit të ankesave ankesat e regjistruara nga biznesi në faqen <https://www.shqiperiaqeduam.al> për rubrikat: Biznesi im dhe aktet shkresore të regjistruara nga protokollit i institucionit me objekt veprimtarinë e biznesit. Të gjitha ankesat e regjistruara në platformë kanë një afat procesimi prej 10 ditësh pune.
 - b) Në rastet kur kërkesë/ankesa ka mungesë në dokumentacion, koordinatori njofton biznesin për këto mangësi dhe afati shtyhet me 10 ditë të tjera pune nga momenti i njoftimit.
 - c) Proceson nga sistemi rastet e regjistruara nga biznesi në faqen <https://www.shqiperiaqeduam.al>, për të gjitha kategoritë e tjera. Të gjitha rastet për rubrikat e tjera në platformë kanë një afat procesimi prej 20 ditësh pune.
 - ç) Përpilon raporte dhe memo informative kurdo kërkohet nga koordinatori i biznesit në Kryeministri dhe në ministri.
 - d) Mban një *database* të rregullt, duke regjistruar në të të gjitha kërkesat/ankesat e ardhura në atë institucion, duke i ndjekur ato deri në kthimin e përgjigjeve pranë biznesit.
2. Koordinatorit i biznesit në Kryeministri mbikëqyr punën e kryer nga koordinatorët e biznesit në ministri dhe institucionet e varësisë, për trajtimin e rasteve të regjistruara në platformë dhe përgjigjet e dhëna nga institucionet e varësisë pranë ministrisë apo dhe vet ministria, duke siguruar dhe bashkërendimin e punëve dhe të detyrave të sipërcituara me ministrin përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes.
3. Koordinatorit i biznesit pranë ministrisë:
 - a) Përgatit dhe dërgon çdo të premte një informacion raportues javor duke përfshirë dhe raportin e institucionit të varësisë te ministri i linjës. Këtë informacion ai e përgatit nën mbikëqyrjen e koordinatorit përkatës në Kryeministri, me miratimin e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje;
 - b) Bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë urdhër, në bashkëpunim me kabinetet e ministrave si dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë;
 - c) Mban kontakte të vazhdueshme me njësitë e tjera organizative, si kabineti i ministrit, sekretari i përgjithshëm, titullarët e institucioneve të varësisë të ministrive që ata mbulojnë, për zbatimin e detyrave;
 - ç) Përgatit çdo 6 muaj një buletin informues gjithëpërfshirës, bazuar në gjithë informacionin dhe veprimtarinë në këtë fushë për institucionin që monitoron; duke e përcjellë te koordinatori i biznesit në Kryeministri, i cili përgatit buletinin e përgjithshëm të biznesit dhe është ministria përgjegjëse për mbrojtjen e sipërmarrjes ajo që e përcjell këtë buletin në adresat elektronike të deklaruara nga bizneset.

4. Koordinatorin pranë ministrit dhe institucionit të varësisë i përgjigjet direkt koordinatorit të biznesit në Kryeministri, duke informuar në çdo kohë eprorët e tij lidhur me aktivitetin ditor, rezultatet e punëve në vazhdimësi si dhe mbi vështirësitë e hasura në lidhje me to.

NR.PROT. 303/1
DATË 2 / / 2020

KRYEMINISTRISË
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË KULTURËS
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E
JASHTME
MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E
SIPËRMARRJES
AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE
AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE
TË TRANSPORTIT RRUGOR
INSPEKTORATIT SHTETËROR TEKNIK
INDUSTRIAL
POSTËS SHQIPTARE
AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE
NATYRORE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT
INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS DHE
SHËRBIMEVE SOCIALE
AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT
AGJENCISË PËR ZHVILLIMIN BUJQËSOR DHE
RURAL
FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR
AGJENCISË SË KONTROLLIT TË BARNAVE DHE
PAJISJEVE MJEKËSORE
AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

